



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 427/15 prot.

Tiranë, më 23.12.2019

VENDIM
Nr.199, datë 23.12.2019

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT
TË ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 73, DATË 19.04.2019, NË
NË INSTITUCIONIN AGJENCIA E TRAJTIMIT TË KONCESIONEVE

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 73, datë 19.04.2019, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në Agjencinë e Trajtimit të Koncesioneve dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”,

KONSTATOVA SE:

Me vendimin nr. 28, datë 19.04.2019, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në Agjencinë e Trajtimit të Koncesioneve”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në institucionin Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve.

Pas përfundimit të mbikëqyrjes, Komisioneri ka dërguar pranë Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve, raportin përfundimtar dhe vendimin paralajmërues për rregullimin e ligjshmërisë me nr. 73, datë 19.04.2019, duke i lënë institucionit detyra për përmirësimin e situatës, si dhe një afat prej 30 ditësh për zbatimin e tyre.

Mbështetur në gjetjet e specifikuara në këtë raport, si dhe në detyrat e lëna për institucionin e mbikëqyrur, në përmbajtjen e vendimit paralajmërues për rregullimin e ligjshmërisë, si dhe duke verifikuar materialin shkresor të dërguar nga institucioni, konstatoj se, situata aktuale e administrimit të shërbimit civil, e specifikuar sipas radhës së detyrave në vendim, rezulton si më poshtë:

Në vendimin paralajmërues të Komisionerit, konkretisht në pikën 2 të tij, është lënë detyrë, për njësinë përgjegjëse, DAP, unifikimin e kategorizimin e pozicioneve të punës në shërbimin civil, në institucionet e varësisë, *(në rastin konkret për pozicionin e punës “Drejtor Drejtorie”)* në përputhje me kërkesat e nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar.

Konstatoj se, institucioni i mbikëqyrur me shkresën nr. 81/6 prot., datë 09.07.2019, me objekt: *“Në vijim të shkresës suaj nr. 427/10 prot., datë 31.05.2019”*, protokolluar pranë Komisionerit me nr. 427/13 prot., datë 10.07.2019, ka sqaruar se, unifikimi i kategorive të pozicioneve të punës, do ti propozohet njësisë përgjegjëse, Departamentit të Administratës Publike, në procesin e ristrukturimit të ATRAKO-s.

Në pikat 3 dhe 4, të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka lënë detyrë për institucionin e mbikëqyrur, të përmbyllë procesin e vlerësimit të rezultateve në punë për Drejtorin e Përgjithshëm të institucionit, i cili është anëtar i TND-së.

Vërej se, nga ana e institucionit Agjencia e Trajtitimit të Koncesioneve janë marrë të gjitha masat për zbatimin e kësaj detyre, konkretisht me shkresën nr. 81/4 prot., datë 08.07.2019, institucioni i mbikëqyrur i ka dërguar zyrtarisht Sekretarit të Përgjithshëm, në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë, formularin e vlerësimit të punës të Titullarit të institucionit, anëtar i TND-së, për të vijuar më tej me procedurën e kërkuar sipas Vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”*, i ndryshuar.

Më tej, në pikën 5 të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka lënë detyrë për njësinë përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit, të përfundojë procesin e hartimit të përshkrimeve të punës, për të gjitha pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil.

Konstatoj se, në përmbushje të kësaj detyre të lënë në dispozitivin e vendimit paralajmërues nr.73, datë 19.04.2019, nga ana e njësisë përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit, janë përfunduar përshkrimet e punës, për të gjitha pozicionet pjesë e shërbimit civil, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në Vendimin nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe*

institucionet e pavarura”, të ndryshuar dhe me shkresën nr. 81/5 prot., datë 08.07.2019, janë dërguar pranë Departamentit të Administratës Publike.

Në pikën 6 të vendimit paralajmërues është lënë detyrë, për njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit, sistemimi i dosjeve të personelit, duke i organizuar dhe plotësuar sipas përcaktimeve të lidhjeve 1 e 2, pjesë e Vendimit nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”*, duke bërë pjesë të saj të gjithë dokumentacionin që është konstatuar si mangësi në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes.

Nga praktika shkresore, rezulton se, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit, në zbatim të detyrës së lënë në vendimin paralajmërues të Komisionerit ka plotësuar dosjet e personelit të çdo nëpunësi sipas lidhjeve nr. 1 dhe 2, pjesë e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 117, datë 05.03.2014. Aktualisht, dosjet e personelit janë në gjendje të mirë dhe administrohen nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore në institucion.

Duke vlerësuar punën e njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore në këtë institucion, si dhe nga gjithë sa u analizua më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të administruar gjatë procesit të verifikimit, arrij në konkluzionin se nga ana e institucionit janë zbatuar drejt detyrimet e lëna në vendimin paralajmërues të Komisionerit dhe janë realizuar plotësisht ato.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 73, datë 19.04.2019, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në Agjencinë e Trajtimit të Koncesioneve dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”*.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve duke zbatuar rekomandimet e Vendimit paralajmërues të Komisionerit Nr. 73, datë 19.04.2019.

3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si dhe Departamenti i Administratës Publike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha